



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Mars 2021

Nr: 107

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, pika 2, neni 65 e 66, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 2 të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” për regjistrimin e koalicionit zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

VËREJ

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Në mbështetje të nenit 65 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, pranë KQZ partitë politike si më poshtë vijon:

1. Partia Demokratike me Kryetar z. Lulzim Basha, miratuar me vendimin, nr.72, datë 15.02.2021;
2. Partia Republikane Shqiptare me Kryetar z. Fatmir Mediu, miratuar me vendimin, nr.73 datë 15.02.2021;



3. Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet me Kryetar z. Shpëtim Idrizi, miratuar me vendimin, nr.33, datë 05.02.2021;
4. Partia Agrare Ambientaliste me Kryetar z. Agron Duka, miratuar me vendimin, nr.54, datë 11.02.2021;
5. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut me Kryetar z. Vangjel Dule, miratuar me vendimin, nr.71, datë 15.02.2021;
6. Partia Demokristiane e Shqipërisë me Kryetar z. Nard Ndoka, miratuar me vendimin, nr.52, datë 11.02.2021;
7. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me Kryetar z. Dashamir Shehi, miratuar me vendimin, nr.60, datë 11.02.2021;
8. Partia Lëvizja e Legalitetit me Kryetar z. Shpëtim Axhani, miratuar me vendimin, nr.32, datë 05.02.2021;
9. Partia Fryma e Re Demokratike me Kryetar z. Bamir Topi, miratuar me vendimin, nr.86, datë 22.02.2021;
10. Partia Bashkimi Liberal Demokrat me Kryetar z. Arian Starova, miratuar me vendimin, nr.68, datë 15.02.2021;
11. Partia Balli Kombëtar Demokrat me Kryetar z. Artur Roshi, miratuar me vendimin, nr.53, datë 11.02.2021;
12. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar me Kryetar z. Ylber Valteri, miratuar me vendimin, nr.55, datë 11.02.2021;
13. Partia Kristian Demokrate me Kryetar z. Dhimitër Muslia, miratuar me vendimin, nr.57, datë 11.02.2021.

Me shkresën nr.1482 prot., datë 24.02.2021, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese Partia Demokratike kërkojnë regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” “PD-AN”, si subjekt zgjedhor për Kuvend e datës të 25 Prill 2021

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BDL-PBKD-PBDSH-PKD”) “PD-AN”, është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.



Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD”);
3. Shkronjat nistore të koalicionit “PD-AN”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Lulzim Basha kryetar i Partisë Demokratike të dorëzojë listat shumemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit
6. Autorizimin e z. Ivi Kaso, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
7. Autorizimin e z. Ivi Kaso, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
8. Autorizimin e z. Ivi Kaso, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ;

Në marrëveshje është përcaktuar instrumenti i propozimit dhe renditjes së kandidatëve të listave shumemërore për çdo parti anëtare e koalicionit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 13 partitë e sipërcituara është në përputhje me nenin 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 65 e 66, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 2, të Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

### **VENDOS**

1. Të regjistroj koalicionin “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:
  - a. Partia Demokratike;
  - b. Partia Republikane Shqiptare;



- c. Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet;
  - ç. Partia Agrare Ambientaliste;
  - d. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
  - dh. Partia Demokristiane Shqipërisë;
  - e. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
  - ë. Partia Lëvizja e Legalitetit;
  - f. Partia Fryma e Re Demokratike;
  - g. Partia Bashkimi Liberal Demokrat;
  - gj. Partia Balli Kombëtar Demokrat;
  - h. Partia Bashkimi Demokrat;
  - i. Partia Kristian Demokrate.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

